



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 150, Datë 28.04.2023

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SH.A., PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213, SERIA PM13P, PËR PRODHIMIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-I “SHKOPET”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13 dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nr. 133/5 prot., datë 27.04.2023 “Mbi kërkesën e shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. për modifikimin e e licencës Nr. 213, Seria PM13P, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 56, datë 24.02.2023, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet” i shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., nga 24 MW në 28 MW.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 28.02.2023 dhe 29.02.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.03.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 133/3 prot., datë 03.03.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 133/4 prot., datë 24.04.2023.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.
- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:

**Neni 15, “Modifikimi i Licencës”, Pika 4, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”.
Plotësuar**

- Leja e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor për HEC “Shkopet” ka afat vlefshmërie 5 (pesë) vjet deri më datë 02.03.2025. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. që të depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidroenergjie nga HEC-i “Shkopet” brenda datës 02.03.2025.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë licencën Nr. 213, Seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 06.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s tek shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Shkopet”, si më poshtë:
Ishte: kapaciteti i instaluar 24 MW
Bëhet: kapaciteti i instaluar 28 MW
2. Në përmbajtjen e licencës Nr. 213, Seria PM13P, të pasqyrohen ndryshimet respektive në përputhje me rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC-it “Shkopet”.
3. Shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. duhet të depozitohet në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidroenergjie nga HEC-i “Shkopet” brenda datës 02.03.2025.
4. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit nga ana e shoqërisë të kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujqore dhe shoqërinë “Operatori Sistemit Transmetimit” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI